

**AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI
I**

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"TO27 CONSTRUCTION" SH.P.K.

Në bazë të ligjit 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar (*këtu e në vijim referuar si LTSHT*), nënshkruesi/t e këtij dokumenti, vendosën si më poshtë vijon:

Kreu I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1- Baza ligjore

1. Hartimi i Statutit bazohet dhe respekton kërkesat e ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.
2. Dispozitat e Statutit kanë karakter të detyrueshëm dhe rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërisë me Ortakët dhe organet e saj si dhe marrëdhëniet mes ortakëve. Çështjet që nuk parashikohen shprehimisht në këtë dokument, rregullohen sipas dispozitave përkatëse të legjislacionit shqiptar.

Neni 2 - Përkufizime

1. Në këtë dokument, nëse nuk përcaktohet ndryshe, termit e mëposhtme kanë këto kuptime:
 - a) "**Shoqëria**" nënkupton shoqërinë tregtare të themeluar sipas këtij dokumenti, me emrin e përcaktuar në nenin 4 të këtij Statuti dhe të ndryshuar sipas rastit, në përputhje me kërkesat e Statutit dhe legjislacionit të zbatueshëm në fuqi.
 - b) "**Statuti**" nënkupton statutin e Shoqërisë.
 - c) "**Ortak(ët)**" Sipas rastit, themeluesit e Shoqërisë ose personat fizikë dhe/ose juridikë që zotërojnë kuotat e Shoqërisë në përputhje me kërkesat e këtij Statuti;
 - d) "**Person**" është çdo person fizik apo juridik;
 - e) "**Ditë të Plota**" në lidhje me periudhën e njoftimit është periudha që nuk e përfshin ditën kur është dhënë ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë ose hyn në fuqi njoftimi.
2. Në këtë Statut, me përjashtim të rastit kur sipas kontekstit të dispozitës përkatëse rezulton ndryshe, shprehjet në numrin njëjës përfshijnë ato në numrin shumës dhe anasjelltas, dhe gjinia mashkullore përfshin edhe atë femërore dhe anasjelltas.


1

Neni 3 - Komunikimet

1. Të gjitha njoftimet dhe/ose komunikime që Shoqëria i drejton Ortakëve sipas këtij Statuti, do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen Ortakëve në adresat e deklaruara prej tyre pranë Administratorit (ëve) të Shoqërisë duke përfshirë dhe komunikimet me mjete elektronike nëse këto të fundit garantojnë konfirmimin e marrjes dhe sigurinë e komunikimit.
2. Të gjitha njoftimet dhe/ose komunikimet e dërguara sipas paragrafit të mësipërm, do të konsiderohen rregullisht të marra nga Ortaku në datën më të hershme midis: (i) datës së marrjes efektive nga Ortaku, (ii) datës së pranimit apo refuzimit të shënuar në njoftimin e marrjes nëse dërgohet me postë të regjistruar; ose (iii) brenda 72 orësh nga dorëzimi pranë një shërbimi të shpejtë postar të njohur ndërkombëtarisht.

Kreu II

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 4- Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1. Sot, më 01/11/2023, themeluesit, krijuan një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar.
2. Emri i shoqërisë është " TO27 Construction " sh.p.k, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me emrin " TO27 Construction" sh.p.k. (këtu e në vijim: "Shoqëria"). Ndryshimi i emërimit të Shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
3. Themeluesi i shoqërisë është:

Turjan Hysko, shtetas shqiptar, i lindur në Berat, më 30.03.1985 dhe banues ne adresen: Margarita Tutulani; Nd. 10; H.1; Ap.11; Njesia Administrative nr. 5, Njesia Bashkiake nr. 5; 1019 Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. BI221545 me nr. Personal I50330003D.

Neni 5 - Objekti

1. Objekti parësor i veprimitarisë është projektimi, ndërtimi, vënia në shfrytëzim, administrimi dhe operimi i njësive të hotelerisë në bregdet, administrimi i saj/tyre dhe ofrimi i shërbimeve të hoteleri-turizmit, si dhe çdo veprimtari tjetër ndihmëse, që lidhet direkt ose indirekt me veprimtarinë e sipërpërmendur.
2. Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose blejë/përfitojë direkt ose indirekt pjesëmarrje, në shoqëri, ndërmarrje, agjenci apo sipërmarrje të tjera, të cilat kanë fushë veprimtarie të ngjashme.
3. Shoqëria, në mënyrë dytësore dhe jo në mënyrë direkte, dhe sidoqoftë vetëm për të përmbushur objektin tregtar të shoqërisë, mund të kryejë çdo veprimtari tregtare, industriale, financiare dhe transaksione në lidhje me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të cilat do të konsiderohen si të nevojshme dhe të domosdoshme nga Organi i Administrimit për përmbushjen e objektit të shoqërisë; gjithashtu mund të përfitojë interes ose pjesëmarrje në shoqëri ndërmarrje, bashkime



2

publike ose private të tjera të cilat kanë një objekt tregtar të ngjashëm, të lidhur me objektin e shoqërisë, direkt ose indirekt, deri në kufirin e lejuar nga ligji në fuqi.

4. Shoqëria mund të lëshojë garanci, kolaterale ose dorëzani, deri në kufirin e lejuar nga ligji në fuqi.
5. Shoqëria mund të ushtrojë aktivitete të tjera ndihmëse ose të lidhura duke përfshirë dhe eksportin, si dhe të gjitha aktivitetet e nevojshme dhe të domosdoshme për të përmbushur objektin e shoqërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6 – Kohëzgjatja

1. Shoqëria themelohet dhe ushtron vepritarinë e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar.
2. Shoqëria mund të priset në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 7 – Selia

1. Selia e shoqërisë është në adresën: Rezidenca Kodra e diellit 2, Apartamenti 298, Tiranë.
2. Shoqëria gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj ka të drejtë të hapë degë apo filiale, zyra përfaqësimi, në të gjithë vendin, brenda ose jashtë territorit të saj.

Neni 8 - Përgjegjësia e Ortakëve

Ortakët e Shoqërisë janë personat që kanë përfituar kuotën e tyre në Shoqëri në përputhje me kontributin e tyre. Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë "TO27 Construction" sh.p.k. dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara prej tyre.

Kreu III

Kapitali dhe Kuotat

Neni 9 - Kapitali i shoqërisë

1. Kapitali i Shoqërisë është 100 (njëqind) lekë dhe është ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale prej 100 (njëqind) lekë.
2. Kapitali është nënshkruar dhe shlyer tërësisht si më poshtë vijon:
 - Turjan Hysko, i cili ka shlyer kontributin në Shoqëri, në para në shumën e barabartë me: 100 (njëqind) lekë.
3. Bazuar në kontributin e sipërcituar, z.Turjan Hysko, ka 1 (një) kuotë, të barabartë me 100% (një qind për qind) të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 10 - Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

1. Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke i ofruar për nënshkrim kuota të reja ortakëve ekzistues të Shoqërisë. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimit të ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të ortakëve.
2. Kontributet e ortakëve mund të konsistojnë në të gjitha format e aktiveve të lejuar nga ligji, duke përfshirë edhe kontributet në natyrë.



3

3. Ortakët mund të financojnë shoqërinë nëpërmjet financime me pagesa, me interes ose pa interes, qoftë si kontribute në kapital ose jo, edhe objekt rimbursimi, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.
4. Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicë të kualifikuar. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e parashikuar me ligj. Zvogëlimi i kapitalit mbartet prej secilit ortak proporcionalisht me kuotat që ai ka në kapitalin e shoqërisë.

Neni 11 – Transferimi i Kuotave

1. E drejta e pronësisë mbi kuotat është lirisht e transferueshme tek të tretët në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare,
2. Ndalohet krijimi i të drejtave reale mbi kuotat e Shoqërisë me qëllim garantimin e detyrimeve të një pale të tretë, me ose pa pagesë, përveçse kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme parashikohet ndryshe.

Kreu IV Asambleja e Përgjithshme

Neni 12 – Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i shoqërisë. Shoqëria përbëhet nga një ortak i vetëm dhe të gjitha kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Ortaku i Vetëm.
2. Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori/Administratorët sa herë kërkohet nga ligji i zbatueshëm apo nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë.
3. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (email) drejtuar çdo ortaku/ortakut të vetëm. Njoftimi duhet të kryhet të paktën tetë Ditë të Plota përpara datës së caktuar për mbledhjen, përveçse kur njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme i cili përmban një afat më të shkurtër është miratuar nga shumica e ortakëve/Ortaku i vetëm. Adresa elektronike e-mail e ortakëve regjistrohet në dokumentet e Shoqërisë.
4. Njoftimi i thirrjes duhet të përmbajë datën, vendin, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës që do të diskutohet në mbledhje. Asambleja e Përgjithshme mund të mbahet në një vend tjetër nga selia e shoqërisë, me kusht që ky vend të jetë në Shqipëri ose në Itali.
5. Asambleja e Përgjithshme për miratimin e pasqyrave financiare duhet të thirret të paktën brenda 120 ditëve nga mbyllja e vitit financiar por në rast të rrethanave të jashtëzakonshme, mund të thirret brenda 180 ditëve nga mbyllja e vitit ushtrimor.
6. Asambleja e Përgjithshme për miratimin e pasqyrave financiare thirret brenda 180 ditëve nga dita e mbylljes së vitit ushtrimor në rast se rrethanat e veçanta e kërkojnë dhe sidoqoftë brenda limiteve dhe kushteve të parashikuara nga ligji.




4

Neni 13 – Kompetencat dhe kuorumi

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) miratimin e shpërndarjes së fitimeve vjetore;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e
- g) pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- i) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- j) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- k) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- l) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- m) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- n) miratimin e degëve dhe zyrave të përfaqësimit të shoqërisë brenda dhe jashtë vendit;
- o) miratimin e krijimit të Joint Venture dhe bashkëpunimeve që mund të kenë të bëjnë me investim, financim, fitim të drejtash apo pjesëmarrjesh në projekte ekzistuese apo të reja;
- p) blerjen dhe shitjen e pjesëmarrjen në shoqëri të tjera;
- q) vendosjen e barrëve, hipotekës, pengut apo garanci të çdo lloj tjetër mbi pasuritë e shoqërisë;
- r) dhënien e çdo garancie korporative ose nënshkrimin e çdo lloj marrëveshje tjetër për të siguruar përmbushjen e detyrimeve financiare ose jo financiare ndaj të tretëve;
- s) shitjen e ndërmarrjes ose degëve të ndërmarrjes;
- t) shitjen, blerjen apo shkëmbimin e pasurive të paluajtshme nënshkrimin e kontratave të sipërmarrjes në lidhje me to, duke përfshirë këtu shitjet e njësive/objekteve të banimit dhe/ose shërbimit tek klientët e interesuar sipas një plan biznesi të miratuar përkatësisht për çdo objekt imobiliar;
- u) akordimin e huave ose paradhënies për Administratorët ose Drejtuesit/Menaxherëve e lartë për nevoja personale;
- v) miratimi i blerjeve, shitjeve, nënshkrimi i kontratave me palë të treta për punë, shërbime apo çdo lloj marrëdhënie tjetër për një vlerë mbi 100.000 EUR (një qind mijë Euro);
- w) miratimin e rregullores/ve së brendshme të Shoqërisë;
- x) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo Statuti.

2. Vendimet e asamblesë së përgjithshme merren në formën e vendimeve me shkrim. Pjesëmarrja apo votimi në asamblesë e përgjithshme, mund të kryhet edhe nëpërmjet mjeteve elektronike. Në këto raste është e nevojshme prania e Noterit.



3. Procesverbali i vendimeve duhet t'i dorëzohet administratorit, i cili e regjistron në regjistrin e vendimeve, që do të ruhet në selinë ligjore të shoqërisë nën kujdesin e tij.
4. Kuorumi i nevojshëm për të vendosur në asamblenë e zakonshme dhe/ose të jashtëzakonshme është ai i parashikuar në nenet 86, 87 të ligjit 9901 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 14 -Procesverbali i Mbledhjes


1. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Procesverbali përmban datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Kryetarit të Mbledhjes, emrin e Mbajtësit të Procesverbalit, rezultatet e votimit.
2. Për mbajtjen e procesverbalit, Kryetari i Mbledhjes cakton një Mbajtës Procesverbali, i cili mund të mos jetë ortak. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga Kryetari i Mbledhjes dhe Mbajtësi i Procesverbalit.
3. Procesverbali i bashkëngjitet lista e pjesëmarrësve dhe njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

Kreu V

Administrimi i Shoqërisë

Neni 15- Administratori/ët

1. Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë. Në rast se Asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, administratorët do të veprojnë bashkarisht përveçse kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.
2. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
 - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - f) hartojnë procedurat e brendshme, urdhrat dhe udhëzimet që duhet të dalin në zbatim të këtij statuti dhe/ose rregulloreve të brendshme të miratuara nga Asambleja e përgjithshme e Shoqërisë.



3. Administratori/ët mund të emërojnë përfaqësues me prokurë të posaçme për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre nga ligji ose ky Statut.
4. Administratori i parë i shoqërisë është z. Turjan Hysko, shtetas shqiptar, i lindur në Berat, më 30.03.1985 dhe banues në adresën: Margarita Tutulani; Nd. 10; H.1; Ap.11; Njesia Administrative nr. 5, Njesia Bashkiake nr. 5; 1019 Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. BI221545 me nr. Personal I50330003D.

Neni 16- Përfaqësimi

1. Administratori i Përgjithshëm përfaqëson në mënyrë të pavarur Shoqërinë në administrimin e zakonshëm dhe të përditshëm dhe është solidarisht përgjegjës për të gjitha çështjet me qëllim të vetëm përfaqësimit e tij me përjashtim të rasteve kur këto çështje shoqërohen me autorizim/vendim/dëshmi të miratuar nga Bordi i Administratorëve. Në rastin e fundit, anëtarët e Bordit të Administratorëve janë bashkërisht dhe solidarisht përgjegjës, Administratori i Përgjithshëm përfaqëson Shoqërinë bashkë me nënshkrimin e dytë të një Administratori të Bordit në raste kur nënshkrimi i dytë kërkohet aktet e Shoqërisë dhe/ose vendimet të miratuara në Asambleshë e Përgjithshme me shumicë të zakonshme rast pas rasti.
2. Kompetencat për të përfaqësuar Shoqërinë mund t'i atribuohet, sipas rastit, (a) Kryetarit të Bordit të Administratorëve dhe/ose (b) secilit prej Administratorëve, bashkërisht ose individualisht në bazë të vendimit të Asambleshë të Ortakëve.
3. Shoqëria mund të përfaqësohet gjithashtu nga drejtor, menaxher dhe avokat, brenda kufizimeve të tagrave të përcaktuara në aktin përkatës të miratimit të leshuar nga Bordi i Administratorëve.

Kreu VI

Eksperti Kontabël, Viti Financiar Dhe Bilanci Vjetor, Shpërndarja e Fitimeve, Prishja

Neni 17 - Bordi i Ekspertëve Kontabël

1. Nëse kërkohet nga ligji ose nëse vendoset nga ortakët, emërohet një Bord Ekspertësh, i përbërë prej tre anëtarësh dhe dy anëtarë alternativë, të emëruar dhe që veprojnë në përputhje me ligjin.
2. Ekspertët Kontabël statutorë do të kenë të gjitha kompetencat e dhëna nga ligji dhe në veçanti ato të lidhura me një kontroll financiar të mundshëm.

Neni 18 - Auditimi

1. Në rastet ku emërimi i Bordit të Ekspertëve Kontabël statutorë është i detyrueshëm, funksioni i auditimit kryhet nga ky Bord i Ekspertëve Kontabël, nëse Asambleja e Përgjithshme nuk vendos për caktimin e një eksperti kontabël ose shoqëri auditimi.
2. Në rastet e caktimit të një eksperti kontabël ose shoqëri auditimi, shpërblimi i tyre vjetor do të përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme në kohën e emërimit të tyre, për të gjithë periudhën mandatit të tyre.

Neni 19- Viti Financiar dhe Pasqyrat Financiare

1. Viti financiar i shoqërisë mbyllet në 31 Dhjetor të çdo viti.



7

2. Në fund të çdo viti financiar, Bordi i Administrimit harton pasqyrat financiare, në përputhje me dispozitat e ligjit.

Neni 20 - Fitimet dhe Dividendët

1. Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.
2. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve vetëm nëse pas pagimit të dividendëve:
3. aktivet e Shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
4. Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Neni 21 – Prishja dhe likuidimi

1. Shoqëria priset në rastet e parashikuara nga ligji ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast prishje Shoqëria do t'i nënshtrohet procedurës së likuidimit.
2. Për procedurën e likuidimit të Shoqërisë do të aplikohet legjislacioni shqiptar në fuqi.
3. Likuiduesi/t do të emërohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Emërimi i likuiduesit/ëve dhe procesi i likuidimit do të kryhen në përputhje me dispozitat e ligjit shqiptar.

KREU VII MOSMARRËVESHJET

Neni 22 - Ligji i aplikueshëm dhe Juridiksioni

1. Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim dhe marrin këshillim me ndërmjetësimin e një konsulenti ligjor i cili ofron mundësi zgjidhje në interesin më të mirë të secilit prej tyre në takime dhe diskutime të përbashkëta.
2. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje gjykatës kompetente të Republikës së Shqipërisë në përputhje me ligjet shqiptare në fuqi.

Neni 23 - Dispozitat Përfundimtare

1. Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohet Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, si dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.
2. Ky Statut është përgatitur në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Nënshkruar në Tiranë në datë 01/11/2023.

Tujan Hysko
